



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezuar Prunjen / Pristato Received / Delivery	03-02-2023	3	viti god Year
Organ / Aqesia Organ / Jednica Org / Unit	No Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	1384/2023		116



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1234/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas r ankesës me numër A.nr.1234/2022 të datës 21.12.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ nga Prizreni më adresë banimi Rr. "Tirana", objekti Fati Grup, Hyrja A1/1, kundër organit të punësimit/Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1234/2022 e datës 21.12.2022, e parashtruar nga ankuesi _____
- II. Shfuqizohet Vendimi KA.nr.38/22 i datës 18.11.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe çështja kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë*.
- III. Obligohet Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____, me datë 21.12.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1234/2022, kundër

Vendimit KA.Nr.38/22 të datës 18.11.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të shkeljes së të drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 23.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 06.01.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshëm në kuptim të nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 8260/2022 të datës 21.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.nr.38/22 të datës 18.11.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Ankesën e datës 08.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në SKPK; Kërkesën për qasje në dokumentet publike e datës 27.10.2022 e parashtruar nga ankuesi; Plikon e datës 19.12.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 8415/2022 e datës 23.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 74/2023 e datës 06.01.2023; Procesverbalin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 14.11.2022; Dëshminë nga libri i pranimit i datës 18.11.2022; Njoftimin për përmbledhjen përfundimtare i datës 06.10.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Raportin Final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutes i datës 30.09.2022 për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Rekomandimin për emërim i datës 30.09.2022 për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Vendimin DPSKPK/Nr.415/2022 i datës 08.09.2022 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 06.09.2022 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Vendimin DPSKPK.Nr.408/2022 i datës 06.09.2022 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Konkurs me referencë KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-015 i datës 22.08.2022; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Formularin për përmbledhjen e vlerësimeve individuale të listës së ngushtë i datës 12.09.2022 për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Formularin e vlerësimeve individuale për listën e ngushtë i datës 12.09.2022 për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Listën përfundimtare e përzgjedhës së listës së ngushtë datës 12.09.2022 për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Njoftimi i kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë për pozitë për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Deklaratën për mos ekzistimin e konfliktit të interesit e datës 12.09.2022 për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Formularin për përcaktimin e kritereve për përfshirje listën e ngushtë për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Formularin për renditjen përfundimtare të kandidatëve për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Formularin për përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Formularin e vlerësimit individuale të intervistës me gojë për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Njoftimin e datës 23.09.2022; Listën e thirrjeve të kandidatëve për intervistë me gojë për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Listën përfundimtare të



përzgjedhjes së testit me shkrim e datës 20.09.2022 për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Formularin e përmbledhjes së vlerësimeve individuale të testit me shkrim për pozitën për Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Formularët individuale përfundimtar të kandidatëve për testim me shkrim dhe me gojë të datës 29.09.2022; Testin me shkrim të ankuesit dhe kandidates D.B i datës 16.09.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Çelësin e përgjigjeve të testit me shkrim; Aplikacionin për punësim të ankuesit për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë i datës 01.09.2022; Kartel identifikimi e ankuesit; Diplomën me Nr.406 e datës 22.01.2018 për ankuesin; Diplomën e datës 19.02.2021; Certifikatë e Notave e datës 27.02.2018; Vërtetim notash i datës 05.11.2020; Vendim me numër 1051-1/2021 i datës 11.10.2021; Certifikatën për kryerjen e stazhit të praktikës e datës 27.03.2019; Diplomën e datës 15.01.2015, 01.11.2015; Certifikatën e datës 06.10.2020 e ankuesit; Letër rekomandim i datës 05.07.2022 për ankuesin; Vendimin Ref.Nr.266/2248 i datës 19.07.2021; Aplikacionin për punësim i kandidates D.B për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë i datës 05.09.2022; Diplomën me Nr. 1751/21 e datës 31.08.2021 për kandidaten D.B; Reference Ap.nr.42/2022 e datës 01.09.2022 për kandidaten D.B; Kontratën për punë praktike vullnetare në Prokurorinë e shtetit e datës 01.12.2021; Referencë e datës 01.09.2022; Vërtetimin e datës 25.08.2022; Vërtetimin AP.nr.128/2018 i datës 24.09.2018; Referencës e datës 18.10.2021; Dokument identifikimi për kandidaten D.B; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë e datës 25.08.2022; Provat për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren-Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare e datës 06.10.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Rekomandimin për emërim i datës 03.10.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Raportin final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 30.09.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 30.09.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës e datës 30.09.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale të intervistës e datës 30.09.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Formulari i vlerësimit të intervistës me gojë për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Lista përfundimtare e përzgjedhjes të testit me shkrim për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Përmbledhje e vlerësimeve individuale të testit me shkrim për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Formularin e vlerësimit individual përfundimtar për testim me shkrim dhe me gojë për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Njoftimin e kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Listën përfundimtare të përzgjedhjes së listës së ngushtë për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Formulari i vlerësimit individual për listën e ngushtë për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Testin me shkrim të datës 16.09.2022 të ankuesit dhe kandidatit G.S për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Aplikacionin për punësim të kandidatit G.S për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren i datës 01.09.2022; Dokument identifikimi; Kontratë për punë praktike vullnetare me Nr. 9 e datës 28.05.2021; Certifikatën AGJ.nr.120/2022 e datës 28.02.2022; Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren e datës 14.04.2022; Diplomën me Nr. 7118 e datës 01.11.2020 për G.S; Aplikacionin për punësim të ankuesit i datës 29.08.2022 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren; Kartelën e identifikimi e ankuesit; Diplomën me Nr.406 e

datës 22.01.2018 për ankuesin; Diplomën e datës 19.02.2021; Certifikatën e Notave e datës 27.02.2018; Vërtetimin e notave i datës 05.11.2020; Vendimin me numër 1051-1/2021 i datës 11.10.2021; Certifikatën për kryerjen e stazhit të praktikës e datës 27.03.2019; Diplomën e datës 15.01.2015, 01.11.2015; Certifikatën e datës 06.10.2020 e ankuesit; Letër rekomandim i datës 05.07.2022 për ankuesin; Vendimin Ref.Nr.266/2248 i datës 19.07.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit _____, është e bazuar, SEPSE:

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 22.08.2022 ka shpallur Konkursin me numër reference KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-015, për pozitën e punës " Zyrtar Ligjor 2" 23 vende pune, me ç' rast ankuesi kishte aplikuar për pozitë të punës rrjedhimisht në Prokurorinë Themelore në Gjakovë (një pozitë) dhe Prokurorinë Themelore në Prizren (një pozitë). Ankuesi është përfshirë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit (listën e shkurtër, testin me shkrim dhe testin me gojë), mirëpo i njëjti sipas Njoftimeve të datës 06.10.2022 të Udhëheqëses së Personelit të SKPK-së nuk ka rezultuar të jetë kandidat i suksesshëm në asnjërën nga njësitë, përkatësisht në pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Prizren ankuesi është vlerësuar me gjithsej 48.1 pikë duke u renditur si kandidati i pestë, ndërsa lidhur me pozitën Zyrtar Ligjor 2 në Prokurorinë Themelore në Gjakovë ankuesi është vlerësuar me gjithsej 43.8 pikë duke u renditur si kandidati i pestë.

I pakënaqur me rezultatin e vlerësimit përfundimtar, ankuesi më datë 08.11.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, i cili më Vendimin me numër KA.nr.38/22 të datës 18.11.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi njoftimet e datës 06.10.2022 për përzgjedhjen përfundimtare për Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe Prokurorinë Themelore në Prizren, lidhur me pozitën e punës " Zyrtar Ligjor 2".

Ankuesi kundër Vendimit KA.nr.38/22 të datës 18.11.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në Këshill, për shkak të shkeljes së të drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar së vendimi i atakuar nuk përbën fare arsytim lidhur me pretendimet e ankueses, dhe së e njëjta në asnjë fazë të kësaj procedure të pranimit nuk ishte njoftuar me rezultatet e arritura duke ju referuar testit me shkrim dhe intervistës me gojë si dhe rezultatit përmbledhës, duke thekuar së organi i punësimit kishte publikuar vetëm njoftimin përfundimtar të datës 06.10.2022 duke pasqyruar vetëm pikët e rezultateve të kandidateve fitues. Tutje, ankuesi pretendon së Komisioni Përzgjedhës ka bërë vlerësim jo të drejtë sepse njëri nga anëtarët e komisionit për njohuritë që lidhen me vendin e punës më ka vlerësuar më zero pikë ndërsa anëtarët e tjerë me kanë vlerësuar me pikë të tjera.

Sipas Konkursit me numër reference KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-015, për pozitën "Zyrtar Ligjor 2" si kritere për këtë vende punë janë përcaktuar: *Përgatitja profesionale dhe kualifikimi: Diplomë Universitare, Fakulteti Juridik dhe Përvoja e Punës- Një (1) vit përvojë të punës profesionale*".

Kolegji i Këshillit në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore ka analizuar vendimin e kundërshtuar më ankesë gjegjësisht Vendimin KA.Nr.38/2022 të datës 18.11.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe si rrjedhojë vlerësoj se i njëjti përmban të meta esenciale që pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, ngase arsyetimi në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit është i pamjaftueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 1.3, 1.4 dhe 1.5 si dhe nenin 83 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit të datës 08.11.2022 nuk ka trajtuar pretendimet kryesore të ankuesit ngase refuzimi i ankesës është bërë vetëm mbi një konstatim të përgjithshëm dhe abstrakt duke theksuar se, citoj: *“Komisioni pas analizimit dhe vlerësimit me kujdes të pretendimeve ankimore ka ardhur në përfundim se ankesa është e pabazuar, për shkak se KZKA-ja nuk ka konstatuar shkelje të nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil... procedura e rekrutimit është zhvilluar konform Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil..... ankuesi sipas vlerësimit të komisionit për pozitën në Prokurorinë Themelore në Gjakovë është vlerësuar... në total 43.8 % ndërsa në Prokurorinë Themelore në Prizren është vlerësuar me 48.1%..... edhe pretendimi i ankuesit se nuk janë raportuar pikët e testit me shkrim dhe intervistës me gojë nuk qëndron, pasi që Komisioni ka vepruar konform Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil ”*.

Bazuar si me lart, në vlerësimin e Kolegjit, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit veç e veç, për faktin se ankuesi në ankesën e tij në mënyrë konkrete pretendon se në asnjë fazë të procedurës nuk ishte njoftuar me rezultatet e arritura dhe se Komisioni Përzgjedhës nuk ka bërë vlerësim të drejtë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar: *“ se Krahës kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë.*

Për më tepër, Kolegji i Këshillit duke ju referuar nenit 9 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se organet publike duhet të veprojnë me transparencë, të garantojnë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë ligj. E mbi këtë bazë konstatimi, rrjedhë detyrimi i organeve publike që me rastin e zhvillimit të procedurës së rekrutimit duhet ti mbajnë të informuar kandidatet pjesëmarrës për pranim në shërbim civil, lidhur me ecurinë e çdo faze të procedurës si dhe rezultatet e arritura, rrjedhimisht në këtë kontekst Kolegji vlerëson se përkitazi me informimin e palës në një procedurë rekrutimi duhet të zbatohen përshtatshmërisë dispozitat e nenit 41 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Theksuar si me lart, e duke qenë se Vendimi me numër protokolli KA.nr.38/22 i datës 18.11.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa është e

bazuar dhe rrjedhimisht vlerësoi që kjo çështja ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast të Ks me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj ankesën e ankuesit të datës 08.11.2022, të eliminoj shkeljet e konstatuar sipas këtij vendimi dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kështu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1234/2022

Avdyll BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovë
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.